



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHIJAK**  
**SEKTORI I NDIHMËS EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE SHOQËRORE**

**PROJEKT-VENDIM**

**“Mbi përcaktimin e kriterëve specifike dhe dokumentacionit për trajtimin me ndihmë ekonomike të familjeve me problem social-ekonomike.**

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për Veteqeverisjen vendore” të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.87/2025 datë 12.12.2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, ligjit nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” si dhe në bazë të kreu IV pika 3 të vendimit nr.597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” si dhe të vendimit të nr.56 datë 22.12.2025 “Për buxhetin e bashkisë “te vitit 2026”.

Këshillit të Bashkisë i

**PROPOZOJME:**

**Të miratojë kriteret specifike dhe dokumentacionin për trajtimin me ndihmë ekonomike të përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmë ekonomike si dhe nga fondi i bashkisë për familjet me problem social-ekonomike si më poshtë:**

1. Familjet që nuk përfitojnë sipas vendimit nr.597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike dhe familjet me gjëndje të vështirë ekonomike.
2. Familjet me k/familjare gra të veja me fëmijë nën 18 vjeç.
3. Familje me k/familjare gra të divorcuara me fëmijë nën moshën 18 vjeç.
4. Vajza nëna me fëmijë nën moshën 18 vjeç.
5. Familje me raste të sëmundjeve të rënda.
6. K/familjare që janë shurdhe mecece që nuk përfitojnë nga statusi i invalidit.

7. Familje me fëmije jetime ,ku njeri prind ka vdekur dhe tjetri është martuar dhe fëmijët janë në ngarkim të gjyshërve, ku fëmijet nuk kanë përfituar kujdestarinë me vendim gjykatë.
8. Pleq të vetmuar dhe të braktisur.

**Për përfituar ndihmën ekonomike mbi fondin i kushtëzuar dhe të fondit të bashkisë këto familje duhet të dorëzojnë në zyrën e ndihmës ekonomike dhe të shërbimeve shoqërore dokumentacionin e mëposhtem:**

- 1 .Kërkesë me shkrim nga k/familjari.
2. Certifikatë familjare.
3. Fotokopje e kartës identitetit mbi moshen 16-vjec.
4. Certifikate personale nen moshen 16-vjec.
5. Certifikate vdekje kur njeri prind ka vdekur.
- 6.Vendim gjykatë për rastet e familjeve te divorcuara.
7. Rastet e sëmundjeve të shoqëruara me dokumentacion nga mjeku.
8. Vërtetime specifike për cdo rast.
9. Fotokopje e tapisë së tokës.
10. Vërtetim si punë kërkues I papunë për personat mbi moshen 18 vjec,I lëshuar nga zyra e Punësimit .
- 11.Akt-verifikimi i gjëndjes social-ekonomike i kryer nga administratori shoqëror,kryeplaku dhe i , njësisë Xhafzotaj ,Gjepalaj,Mamainas .

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Kozeta Doda**



**KRYETARI**

**Elton Arbana**

